



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 035

Prishtinë, më 18 shtator 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 18 SHTATOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit Haliti**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 102 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai propozoi që pika e 8-të të hiqet nga rendi i ditës. Ai kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen për këtë propozim.

Të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare deklaruan se e mbështesin propozimin e kryetarit që pika e 8-të të hiqet nga rendi i ditës.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, Kryetari hodhi propozimin në votim. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për--- shumica absolute;
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se pika e 8-të – Propozimvendimi i kryeministrit për emërimin e ministrit të Forcës së Sigurisë hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se kjo materie është e rregulluar me Kushtetutë.

Kryetari i Komisionit për Buxhet dhe Financa, Gani Koci, propozoi që pika e 9-të të hiqet nga rendi i ditës, me arsyetimin se komisioni ka kërkuar të dhëna shtesë për ta specifikuar propozimin lidhur me këtë pikë.

Zëvendëskryeministri, Hajredin Kuçi, deklaroi se pajtohet me propozimin e kryetarit të Komisionit për Buxhet dhe Financa, me arsyetimin se Qeveria angazhohet për respektimin e procedurave legjislative.

Kryetari e hodhi në votim propozimin e Gani Kocit. Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për--- shumica absolute;
Kundër-----1,
Abstenime-----1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shimë votash, vendosi që pika e 9-të – Propozimvendimi i Qeverisë për ndarjen e mjeteve financiare Ministrisë së Forcës së Sigurisë, hiqet nga rendi i ditës.

Deputeti Fatmir Rexhepi propozoi që në seancën e sotme të përfshihen edhe dy pika: a) të kërkohej një informatë nga Qeveria lidhur me mundësitë buxhetore për ngritjen e pagave në sektorin: e policisë, të shëndetësisë, të gjyqësisë dhe të administratës, dhe b) të debatohet lidhur me menaxhimin e mjeteve të Trustit Pensional të Kosovës.

Kryetari tha se propozimet duhet të parashtrihen me shkrim, konform rregullave procedurale të Kuvendit.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d i t e:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmjetësim, dhe
8. Shqyrtimi i Propozimvendimit për formimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008

Procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 29 dhe 30 korrik 2008 u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Xhevdet Neziraj** i parashtoi pyetje ministrit për Komunitete dhe Kthime, **Boban Stanković** lidhur me veprimet e ndërmarra nga Qeveria për të kthyerit e komunitetit egjiptas nga vendet perëndimore.

Përgjigja mbeti për seancën e radhës, ngase ministri **Boban Stanković** nuk ishte i pranishëm në seancë.

Deputeti **Xhevdet Neziraj** i parashtoi pyetje ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal **Sadri Ferati** lidhur me numrin e të punësuarve egjiptas në shërbimin civil të Kosovës, jashtë zyrave lokale të komuniteteve.

Ministri **Sadri Ferati** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Neziraj**.

Deputeti **Driton Tali** i parashtoi pyetje ministres së Energjisë dhe të Minierave **Justina Pula-Shiroka** dhe ministrit të Punëve të Brendshme **Zenun Pajaziti** lidhur me planet e Ministrisë së Energjisë dhe të Minierave dhe të Ministrisë së Punëve të Brendshme për luftimin dhe ndalimin e vjedhjeve në KEK

Ministrja **Justina Pula** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Tali**.

Deputetja **Drita Kadriu** i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, **Enver Hoxhaj** lidhur me ndërtimin e strukturave organizative funksionale në MASHT.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadriu**.

Deputetja **Drita Kadriu** i parashtoi pyetje ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve **Valton Beqiri** lidhur me projektet e Ministrisë për mbrojtjen e monumenteve “Ura e gurit” dhe “Kalaja e vjetër” në qytetin e Vushtrrisë.

Ministri **Valton Beqiri** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Kadriu**.

Deputeti **Arsim Rexhepi** i parashtoi pyetje ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal, **Sadri Ferati** lidhur me rritjen e numrit të këshilltarëve në Kuvendin komunal të Vushtrrisë.

Ministri **Sadri Ferati** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rexhepi**.

Deputetja **Myrvete Pantina** i parashtoi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me mundësinë që Qeveria e Kosovës të ndërmarrë veprime për zgjidhjen e problemit të furnizimit me ujë në komunën e Vushtrrisë.

Kryeministri **Hashim Thaçi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Pantina**.

Deputeti **Ibrahim Makolli** i parashtroi pyetje ministrit të Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Nenad Rashi**q lidhur me mospërfshirjen e invalidëve ushtarakë para vitit 1999 në skemën e re të përkrahjes sociale dhe pensionale.

Ministri **Nenad Rashi**q iu përgjigj pyetjes së deputetit **Makolli**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë **Alush Gashi** lidhur me Entin e Medicinës Fizikale dhe Rehabilitimin “Ilixha”.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme **Zenun Pajaziti** lidhur me regjistrimin e automjeteve me targa zyrtare të cilat do të respektohen nga të gjithë shtetasit, dhe ndalimin e regjistrimit me targa të një shteti tjetër.

Ministri **Zenun Pajaziti** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Punëve të Brendshme **Zenun Pajaziti** lidhur me masat konkrete të ministrisë për thjeshtësimin e procedurave të pajisjes së shtetasve të Republikës së Kosovës me dokumente të udhëtimit, veçanërisht të atyre në mërgatë.

Ministri **Zenun Pajaziti** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë **Enver Hoxhaj** lidhur me reformat në arsimin universitar dhe perspektivën e të rinjve që vijnë apo janë në përfundim të studimeve në universitetet private.

Ministri **Enver Hoxhaj** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë **Alush Gashi** lidhur ndarjen e mjeteve shtesë nga Ministria për trajtimin jashtë vendit të pacientëve me probleme kardiovaskulare dhe kardiokirurgjike.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

3. Interpelanca e ministrit të Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të AKR-së

Kryetari tha se Kryesia e Kuvendit, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare ka ndarë kohën e diskutimit për secilin grup parlamentar në bazë të numrit të deputetëve që ka në Kuvend. Koha prej dy (2) orëve sa do të zgjasë kjo interpelancë, u është ndarë grupeve parlamentare, si vijon: PDK-ja -37 minuta; LDK -25 minuta; AKR-13 minuta; AAK -10 minuta; LDD-11 minuta, Grupi Parlamentar “7+” - 7 minuta dhe SLS- 3 minuta.

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Grupit Parlamentar të AKR-së ta paraqesë mocionin.

Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, **Ibrahim Gashi** tha se Grupi ynë parlamentar, por edhe opinioni i gjerë kosovar, tashmë ka parë qartë ngecjen e madhe që ka ndodhur dhe po

ndodhë në ndërtimin e strukturës së Ministrisë së Punëve të Jashtme, hartimin e strategjisë afatshkurtër dhe afatmesme të politikës së jashtme të Kosovës, vonesën e madhe të pajustificueshme në ndërtimin e shërbimit diplomatik të Kosovës dhe për pasojë ngathtësinë e theksuar deri në shkallë dështimi në çështjen e lobimit për njohjen e shtetit të Kosovës nga shumica e vendeve anëtare të OKB-së.

Si pasojë e mungesës së një programi të parapërgatitur, kjo Ministri nuk ka arritur as tani, tre muaj pas formimit të saj, të krijojë në strukturë dhe një staf efektiv, i cili mund të marrë përsipër përgjegjësinë e madhe që e ka kjo Ministri në procesin e shtetndërtimit të Kosovës.

Gjendja bëhet edhe më pesimiste kur kihet parasysh mënyra e përzgjedhjes së kuadrove të para në këtë Ministri. Jotransparenca dhe nepotizmi i theksuar ka rezultuar që këtu më shumë të ketë gjuhëtarë dhe përkthyes, dhe pothuaj asnjë të kualifikuar dhe me përvojë në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

Hapja e misioneve diplomatike nuk ndodhi edhe pas hyrjes në fuqi të Kushtetutës. Sot, më 18 shtator, të ngarkuarit me punë në 10 misionet e para diplomatike akoma ndodhen në Prishtinë.

Në diplomaci ka një rëndësi të veçantë elementi i faktit të kryer. Prezenca e flamurit dhe e stemës së Republikës së Kosovës në Uashington, në Bruksel, në Londër, Berlin, Ankara dhe në qendra të tjera të vendimmarrjes ndërkombëtare do ta kishte efektin e fuqishëm psikologjik se Kosova tashmë është subjekt legal në marrëdhënie ndërkombëtare ose, të paktën, po sillet si e tillë.

Përzgjedhja dhe dekretimi i 10 të ngarkuarve të parë me punë, dhe së fundi i 10 sekretarëve të parë, është edhe një performancë jokredibile e kësaj Ministrie. Me pak përjashtime, të ngarkuarit me punë nuk posedojnë kredencialet e domosdoshme profesionale e akademike dhe as përvojën në prezantimin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Kosovës në këto momente i duhen diplomat me cilësi dhe shkathtësi të jashtëzakonshme.

Kuvendi i Kosovës është privuar nga misioni i tij mbikëqyrës në këtë Ministri edhe me rastin e vendimit të Qeverisë, të marrë në mbledhjen e 27 gushtit, për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 25 milionë eurosh që do të përdoren për blerjen e ndërtesave për përfaqësitë diplomatike dhe konsullore jashtë vendit.

Ngecjet e sipërpërmendura të Ministrisë dhe të ministrit, përveç tjerash janë reflektuar ndjeshëm edhe në segmentin e lotimit, që pas 15 qershorit do të duhej të ishte pjesë e rëndësishme e strategjisë së kësaj ministrie.

Grupi Parlamentar i AKR-së, shqetësimet mbi punën e ministrit Hyseni dhe të Ministrisë që ai drejton, i adreson në formën e pyetjeve për ministrin:

1. Si është e mundur që, zoti ministër, keni marrë postin dhe keni qeverisur 3 muaj pa një program dhe plan të qartë veprimi?
2. A keni strategji të shkruar afatmesme të zhvillimit të diplomacisë, të politikës së jashtme të Kosovës, që të mund ta prezantoni sot?
3. A mund të na i numëroni kriteret e përzgjedhjes së 10 të ngarkuarve të parë dhe të ndihmësve të tyre dhe a keni marrë pjesë ju në përzgjedhjen e tyre?

Kryetari ftoi ministrin e Punëve të Jashtme, Skender Hyseni, të marrë fjalën.

Ministri i Punëve të Jashtme, **Skender Hyseni**, tha se Ligji për themelimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës është miratuar më 13 mars 2008, ndërsa ministri i Jashtëm është nominuar më 4 prill 2008.

Ministria e Punëve të Jashtme ka mandat ligjor që të jetë përçuesi dhe mbrojtësi i interesave të Kosovës dhe të qytetarëve të saj jashtë vendit. Aktualisht, interesat parësore të Kosovës dhe të qytetarëve të saj janë përshpejtimi i procesit të njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës.

Duke u nisur nga kjo, unë si ministër dhe bashkëpunëtorët e mi, që nga themelimi kemi pasur dy prioritete kryesore në punën tonë. Së pari, ndërtimi dhe funksionalizmi i Ministrisë dhe, së dyti, zhvillimi i kontakteve dhe i veprimeve të tjera për të përshpejtuar këtë proces.

Një nga prioritetet kryesore të angazhimeve të Ministrisë ka qenë ndërtimi i strukturave dhe funksionalizimi i tyre dhe kjo nuk është punë e lehtë. Kjo bëhet edhe më sfiduese kur kihet parasysh mungesa e përvojës, e traditës diplomatike të Kosovës, sidomos sa i përket shërbimit të jashtëm si dhe mundësitë e kufizuara financiare.

Kam themeluar një ekip të veçantë për t'u marrë me organizimin strukturor dhe funksionalizimin e Ministrisë. Ky ekip ka përgatitur organogramin e Ministrisë dhe Udhëzimin përkatës administrativ, si dhe aktet e tjera përkatëse ligjore.

Ministria ende ka mungesë të infrastrukturës bazë për realizimin e detyrave dhe të përgjegjësisë. Ende funksionojmë në kushte pune jo optimale, jo për fajin tonë. Ende nuk ka hapësirë të mjaftueshme për akomodimin e të gjithë stafit civil.

Ministria ka hapur konkurse për rekrutimin e stafit civil. Deri më tani kemi rekrutuar një pjesë të stafit të planifikuar, dhe këto ditë jemi në proces të rekrutimit të pjesës tjetër të stafit.

Krahas ndërtimit dhe funksionalizimit të Ministrisë, angazhimi ynë ka qenë në procesin e njohjes ndërkombëtare të shtetit të Kosovës.

Që nga dita ime e parë si ministër, së bashku me bashkëpunëtorët e mi, kemi filluar procesin e përgatitjes së analizave dhe të planifikimit të veprimeve që të ndikohet në njohjen ndërkombëtare të Republikës së Kosovës. Mbi bazën e analizave të tilla, Ministria ka përgatitur dhe zbatuar një plan konkret të implementuar në veprime konkrete që në diskursin tonë të përditshëm po quhen aktivitete lobuese.

Ministria, që nga dita e parë e punës së saj është angazhuar që të zhvillojë sa më shumë kontakte të drejtpërdrejta, të dyanshme dhe të shumanshme, me përfaqësues vendesh që nuk e kanë njohur shtetin e Kosovës.

Vazhdimisht kemi bërë përpjekje që të realizojmë vizita të drejtpërdrejta, por kjo jo gjithmonë ka pasur përgjigje pozitive në kërkesat tona. Duhet thënë qartë se shumë vende që nuk e kanë njohur Kosovën, ende hezitojnë të kenë kontakte në nivel të lartë zyrtar me Kosovën.

Në procesin e punësimit të Shërbimit Civil të Ministrisë ju siguroj se nuk ka pasur familjarizëm, nuk ka pasur nepotizëm. Por, ka pasur respektim fundamental dhe rigoroz të ligjeve në fuqi dhe të dispozitave ligjore.

Po kështu, sa i përket përzgjedhjes së të ngarkuarve me punë, të 10 të ngarkuarve të parë me punë, nuk ka pasur absolutisht qasje tjetër përpos respektimit të kriterëve të profesionalizmit, të integritetit moral dhe kombëtar të tyre.

Pastaj, kryetari e hapi debatin lidhur me Interpelancën e ministrit Skender Hyseni.

Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, **Ramë Buja** tha se është pak e tepruar ajo që kërkohet nga opozita, por është detyrë e saj të kërkojë gjithnjë më shumë, sepse është një kohë tepër e shkurtër nga miratimi i Ligjit për Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe mundësitë që kanë qenë bukur shumë të kufizuara për t'u konsoliduar si strukturë ministrore dhe puna që është bërë.

Unë dakordohem me ministrin, në veçanti në pjesën ku lobimi nuk është esenca e Ministrisë së Punëve të Jashtme, do me thënë, është pjesë e saj, por detyrat e Ministrisë janë shumë më të mëdha se sa vetë lobimi. Grupi ynë parlamentar i jep përkrahje dhe përgëzon ministrin dhe dëshiron që angazhimi i tij të jetë shumë më i madh se sa ishte deri me sot.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, **Lutfi Haziri** tha se mbështet angazhimet dhe përkushtimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, të ministrit në realizimin e politikave, të programit qeveritar, të kërkesave të Kushtetutës në realizimin e detyrës së tij.

Koordinimi ndërinstitutional në realizimin e politikave të jashtme është njëra nga sfidat që edhe dje e kam paraqitur para ministrit në Komisionin parlamentar për Punë të Jashtme. Kushtetuta ia njeh të drejtën edhe Presidentit, Kryeministrit, por edhe Kuvendit, që në këto angazhime të kenë detyra konkrete apo përgjegjësi konkrete.

Ministri duhet të punojë më shumë në koordinimin e krejt këtyre aktiviteteve, në mënyrë që politikat e jashtme të jenë të koordinuara me Presidentin, me Kryeministrin dhe me diplomacinë parlamentare, dhe në këtë fazë të realizimit Kosova duhet të kalojë në ofensivë diplomatike.

Në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, **Ardian Gjini** thëse politika e jashtme e Kosovës nuk është vetëm e ministrit të Punëve të Jashtme, është edhe e Presidentit, është edhe e Kryeministrit, mirëpo në këtë rast flamurin e ka ministri i Punëve të Jashtme, sepse pjesa dërmuese e barrës i bie ministrit të Punëve të Jashtme.

Ai në vazhdim i parashtroi disa pyetje ministrit të Jashtëm: A ndjeheni përgjegjës për situatën në të cilën jemi? Këtë duhet ta thotë edhe Presidenti i Kosovës edhe Kryeministri i Kosovës.

Ministrinë e Punëve të Jashtme e karakterizon joserioziteti në punën e saj, nepotizmi në punësimin e stafit të saj, sidomos në përfaqësitë diplomatike.

Ministria nuk ka lobuar në Lindjen e Mesme për njohjen e Kosovës. U tha se lobimi nuk është puna më kryesore, ka punë shumë më të mëdha. Çka ka Ministria e Punëve të Jashtme të Kosovës punë tjetër? Qeveria, pa sens diplomatik, ka dhënë deklarata ofenduese për vendet që ende nuk e kanë njohur Kosovën.

Sa vende i ka vizituar ministri? Ka shkuar në Shqipëri me datën 3 shtator dhe cila ka qenë arsye e saj?

Për këto çështje që u ngritën, duhet dhënë përgjigje. Dikujt duhet t'i themi që i ke fajet, të paktën pak, pse erdhi situata kështu si është?

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, **Lulzim Zeneli** tha se nëse e analizojmë punën e Ministrisë së Punëve të Jashtme, atëherë me plotë kuptim mund të themi se kjo ministri paraqet kulmin e dështimeve të saja, kulmin e dështimeve të kësaj Qeverie.

Kjo Qeveri merret me pasoja. Njëherë duhet të ndodhë diçka, pastaj ne të planifikojmë ndonjë strategji të caktuar.

Ministrin e Punëve të Jashtme mbrëmë patëm rastin ta dëgjojmë, se nëse kalon propozimi i Qeverisë serbe në Asamblenë e OKB-së, atëherë ne do të ndërtojmë strategji lobuese për t'iu kundërvënë pasojave të mundshme. Kjo është filozofia e kësaj Qeverie.

Duhet të rikujtojmë ministrin e Punëve të Jashtme se ndërmjet prononcimit publik dhe realitetit faktik është një diskrepancë e madhe.

Nuk kemi arritur edhe më tutje, u tha nga kolegët, të ndërtojmë shërbime diplomatike, nuk kemi intensifikim të njohjes edhe pse është premtuar se në shtator do të pritët një valë e re njohjesh.

Ministri Hyseni duhet publikisht të sqarojë, pse edhe kjo Qeveri, që është e re, në startin e punës së vet nuk arriti t'i shmanget kancerit të shoqërisë tonë, i cili është nepotizmi, joprofesionaliteti, korniza partiake, e kështu me radhë.

Thënë shkurt, nëse do të kishte një njësi matëse që do t'i maste rezultatet e punës së kësaj Qeverie, atëherë kjo do të ishte e barabartë sikurse të mos ekzistonte fare kjo ministri.

Në emër të Grupit Parlamentar “7+” **Xhezair Murati** tha se tema për të cilëndo diskutohet është një proces prej shpalljes së pavarësisë, mbi shtatë muaj, dhe nuk na kanë pranuar një numër i mjaftueshëm i vendeve. Kjo hap shumë çështje.

Shumëkush shton pyetjen pse nuk na kanë pranuar vendet arabe? Pse Serbia, vend me shumicë të popullatës të përkatësisë fetare të krishterë ka arritur të ketë aq shumë ndikim në vendet arabe?

Ministria e Punëve të Jashtme, në të ardhmen duhet më tepër ta zhvillojë aktivitetin lobues në vendet arabe për ta njohur pavarësinë e Kosovës.

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, **Branisllav Grbiq** tha se politika ndërkombëtar dhe procesi i njohjes së pavarësisë së një vendi është një çështje shumë komplekse dhe për këtë duhet të angazhohemi të gjithë. Vendet që presin ta njohin pavarësinë e Kosovës dhe të investojnë, dëshirojnë të shohin një kualitet më të mirë.

Njerëzit profesionistë, jo vetëm në Qeveri, por edhe në institucionet e tjera mund të kontribuojnë më shumë që procesi i njohjes të ecën më shpejt.

Ne pjestarët e bashkësisë serbe, sikur edhet të bashkësive të tjera, me punën tonë do kontribuojmë që ky proces të përmbyllet sa më shpejt që është e mundshme.

Në emër të Komisionit për Punë të Jashtme, **Sabri Hamiti**, tha se flet si kryetar i Komisionit, por jo në emër të Komisionit. Po flasim për një temë kapitale të politikës së jashtme të Kosovës, e cila është fokusuar si interpelancë për ministrin e Jashtëm, por unë e konsideroj hapje të një teme të madhe në Kuvendin e Kosovës.

Politikë e jashtme e Kosovës, nuk guxon të fokusohet vetëm te një funksionar, sepse ministri i Jashtëm nuk është asgjë më shumë as më pak se një funksionar në Qeverinë e Kosovës, ndërsa politika e jashtme e Kosovës nënkupton Presidentin e Republikës së Kosovës, Kryeministrin e Republikës së Kosovës dhe resorin e politikës së jashtme.

Është një dije elementare që fuqia politike e politikës së jashtme të një vendi nuk është asgjë tjetër veç se derivim i fuqisë së brendshme të atij vendi, qoftë politike, ekonomike, civilizuese, kulturore, demokratike - ajo është reflektim i fuqive të brendshme.

Kjo pavarësi e shpallur është pavarësi e kontraktuar me Bashkësinë Ndërkombëtare, dhe politika jonë e jashtme mos mendoni që është e pavarur, por shumë e varur, ajo është e varur nga shtetet që e kanë pranuar deri tash Kosovën, ose që e kanë sponsoruar edhe pavarësinë, edhe shpalljen e pavarësisë së Kosovës.

Është mirë ta them unë si deputet, nëse nuk donë ta thonë publikisht adresantët më të mëdhenj përfaqësues të Kosovës, sepse qoftë edhe zgjidhjet përfaqësuese politike janë të detyruara të bëhen në konsultime me ta dhe kjo ka ndodhur dhe do të ndodhë, andaj nuk është mirë që sendet që i dimë, t'i plasojmë si çudira në opinion.

Rikonstruktimi i Ministrisë së Jashtme është punë që duhet të bëhet shpejt. Ajo është punë absolutisht e ministrit, nën udhëheqje të tij, por jo edhe zgjedhja e përfaqësuesve. Përfaqësuesit e Kosovës në botën e jashtme ministri i Jashtëm, Skënder Hyseni, nuk i ka zgjedhur. Ajo zgjedhje është bërë kryesisht në konsultim Kryeministër-Kryetar i vendit.

Kryeministri **Hashim Thaçi** tha se ky vit është viti apo kulmi i të arriturave kosovare, e në kuadër të kësaj edhe i diplomacisë kosovare. Pse? Pavarësia e Kosovës është shpallur në mënyrë të koordinuar, duke respektuar vullnetin e qytetarëve të Kosovës për shtet të pavarur, sovran dhe demokratik, por me mbështetje të fuqishme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe të Bashkimit Evropian.

Sot, Kosova është njohur prej 47 shteteve, prej Shteteve të Bashkuara të Amerikës, prej 22 vendeve të Bashkimit Evropian, prej 7 vendeve të G-8-shit, të Japonisë, Australisë dhe të vendeve tjera.

Lobimi për njohjen e pavarësisë së Kosovës ka qenë qëllimi, përkushtimi, sakrifica e të gjithë neve dhe e qytetarëve të Kosovës. Prandaj, në këtë drejtim Ju ftoj të gjithëve të punojmë bashkërisht si Qeveri, si koalicion, si opozitë, si politikë kosovare me partnerë ndërkombëtarë që ta rrisim numrin e njohjeve për shtetin tonë. Në këtë drejtim mund të punohet edhe më tepër sepse edhe vendet tjera, të cilat ende nuk e kanë shpallur vendimin për njohjen e pavarësisë së Kosovës, në veçanti disa prej të cilave janë edhe anëtare të Bashkimit Evropian, presim ta njohin Kosovën, si: Portugalia, Rumania, Sllovakia, Greqia etj.

Nisma e Serbisë, drejtuar Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara për ta kërkuar mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për legjitimitetin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës, është një nismë shumë e keqe dhe fare nuk i kontribuon përmirësimit të marrëdhënieve ndërmjet dy shteteve tona: Kosovës dhe Serbisë.. Prandaj, ne duhet të jemi të përkushtuar dhe jo të dramatizuar me veprimin e Serbisë. Të mos ekzagjerohet roli i Serbisë, por të punojmë me seriozitetin dhe përgjegjësinë më të madhe.

Do të mund të kemi edhe në të ardhmen e afërt vështirësi të natyrave të ndryshme, por asgjë nuk do të na ndalë në procesin e njohjes së pavarësisë së Kosovës dhe të bërjes së saj pjesë të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me Interpelancën e ministrit Skender Hyseni dhanë edhe këta deputetë: **Numan Baliq, Gjylnaze Sylja, Rasim Selmanaj, Zylfije Hundozi, Adem Salihaj, Edita Tahiri, Berat Luzha, Rita Hajzeraj, Behxhet Pacolli, Njomza Emini, Berim Ramosaj, Suzanë Novobërdaliu, Arsim Rexhepi, Driton Tali, Zef Morina, Xhavit Haliti,**

Hajdin Abazi, Sadik Idriz, Gani Buçinca, Ramadan Avdiu, Bujar Bukoshi dhe Besa Gaxheri, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Ministri **Skender Hyseni** iu përgjigj vërejtjeve dhe pyetjeve të deputetëve.

Në fund, në emër të propozuesit të mocionit, **Ibrahim Gashi** përmbylli interpelancën duke theksuar se qëllimi i kësaj interpelance është arritur dhe opinioni tash e ka të qartë se në politikën e jashtme të Kosovës ka defekte të ndjeshme, të cilat, prej kësaj foltore, në emër të gjithë atyre që i vërejtën këto defekte, e ftoj ministrin që të reflektojë shumë përgjegjshëm me aktin moral që ai e konsideron se është i përshtatshëm për barrën e përgjegjësisë që e ka.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantoj Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Mahir Yagcilar**, në emër të Qeverisë, tha se Projektligji rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njërive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta dhe pajisjeve të ndërtesës ose bashkëpronësinë në ndërtesë.

Nevoja për këtë Projektligj është ngase në Kosovë aktualisht nuk ka mekanizma ligjor të cilët do të rregullonin bashkëpronësinë në ndërtesë dhe sidomos organe apo autoritete përgjegjëse të cilat do të merreshin me administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit të ndërtesave.

Krijimi i një sistemi të qëndrueshëm për administrimin dhe mirëmbajtjen e fondit të ndërtesave në mënyrë të qëndrueshme dhe teknike profesionale është nevojë jetike dhe fundamentale.

Projektligji përmban 5 kapituj.

Kapitulli i parë – dispozitat e përgjithshme;

Kapitulli i dytë – shfrytëzimi i njërive në ndërtesë;

Kapitulli i tretë – administrimi dhe mirëmbajtja e bashkëpronësisë në ndërtesë;

Kapitulli i katërt – kundërvajtjet dhe gjobat;

Kapitulli i pestë – dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Në fund, ministri Yagcilar i ftoi deputetët ta miratojnë Projektligjin, në parim.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hajdin Abazi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Myrvete Pantina, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Suzanë Novobërdaliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Et'hem Çeku, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Lulzim Zeneli, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Kosara Nukoliq, si dhe deputeti Riza Smaka, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesës në bashkëpronësi.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Mjedis e Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Ministri **Lutfi zharku**, në emër të Qeverisë parashitroi arsyet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit, fushëveprimin e këtij projektligji, si dhe rolin dhe rëndësinë që ka për sistemin e gjithmbarshëm ekonomik të Kosovës.

Qeveria zhvillon legjislacionin në mënyrë që të mbrojë qytetarët e vet nga rreziku që vjen nga produkte jo të sigurt.

Në funksion të përmbushjeve të obligimeve për të asociuar në mekanizmat e BE-së dhe duke pretenduar për një qasje të mundshme në tregun unik të BE-së, industrisë kosovare i nevojitet infrastrukturë e nevojshme për të filluar procesin e përafrimit me kërkesat themelore që shtrojnë direktivat e Bashkimit Evropian.

Zbatimi i këtij ligji ndikon drejtpërdrejt në zvogëlimin e dështimit të produkteve, mbrojtjen e shëndetit dhe sigurisë së njeriut, mbrojtjen e interesave të ligjshme të konsumatorit përmes plotësimit të kriterëve të caktuara të produkteve si dhe shërbimeve që në ligj e quajmë konformitet, respektivisht përputhje e kërkesave të produkteve, të shërbimeve dhe sistemeve me standardet dhe kërkesat tjera të specifikimeve teknike, që praktikisht të mund të vlerësojmë produktet, shërbimet, pajisjet dhe sistemet e menaxhimit.

Njësia e rregullave teknike e cila funksionon në bazë të Ligjit në fuqi, gjatë hartimit dhe implementimit të rregulloreve të ndryshme teknike që dalin nga direktivat e BE-së ka hasur në vështirësi në kapitullin III të Ligjit në fuqi. Në Ligjin aktual kanë munguar disa procedura për vlerësim të konformitetit, të cilat me Projektligjin e propozuar plotësohen edhe me gjashtë sosh, siç janë: vlerësimi i konformitetit me zgjedhje sipas rastit; vlerësimi në ndërmarrje dhe mbikëqyrja e funksionimit të sistemit; vlerësimi i konformitetit me një tip të produktit të certifikuar; vlerësimi i aktiviteteve lidhur me prodhimin e produkteve; vlerësimi në fazën e projektimit, e tjera.

Duke marrë parasysh rëndësinë e konformitetit të produkteve, po ashtu kemi propozuar edhe rritjen e ndëshkimeve.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Safete Hadërgjonaj, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Xhevdet Neziraj, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Berim Ramosaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Myfera Shinik, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Kosara Nukoliq, si dhe deputetët Riza Smaka dhe Gjylanze Sylja, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----60,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 02/L-20 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Ekonomi, Tregti dhe Industri, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, Komisionin për Komunitete, dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Presidentin e Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri, **Ramë Manaj**, në emër të Qeverisë tha se me këtë projektligj rregullohet materia juridike nga aspekti i të drejtave dhe detyrimeve të Presidentit të Republikës së Kosovës dhe të familjes së tij gjatë dhe pas mandatit të tij.

Projektligji është pjesë e legjislacionit të ri dhe nuk ekziston ndonjë akt tjetër ligjor në fuqi, natyrisht përveç dispozitave përkatëse të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, që rregullon këtë materie në Kosovë.

Kapitulli i parë i Projektligjit rregullon dispozitat e përgjithshme, ndërsa kapitulli i dytë rregullon të drejtat e Presidentit të Republikës së Kosovës pas përfundimit të mandatit, të drejtat e familjes së tij, dhe pjesa tjetër ka të bëjë me të drejtat e familjes së Presidentit të Republikës së Kosovës në rast të vdekjes së presidentit gjatë ushtrimit të mandatit.

Me këtë Projektligj rregullohet edhe teksti i betimit të Presidentit të Republikës së Kosovës. Ky Projektligj ka gjithsej 30 nene.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës
Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së,

Adem Salihaj, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Shpresa Murati, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Kosara Nukoliq, si dhe deputetët Emrush Xhemajli, Mimoza Ahmeti, Edita Tahiri, Suzanë Novobërdaliu, Riza Smaka dhe Sabri Hamiti, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----52,
Kundër-----0,
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi njëzëri miratoi, në parim, Projektligjin për Presidentin e Republikës së Kosovës.

Kuvendi ngarkoi Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi, si komision funksional dhe raportues, Komisionin për Buxhet dhe Financa, Komisionin për Komunitete, dhe Komisionin për Integritet Evropian që ta shqyrtojnë këtë projektligj brenda dy muajve dhe Kuvendit t’ia paraqesin raportet me rekomandime.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndërmjetësim

Kryetari i informoi deputetët lidhur me procedurat e shqyrtimit të Projektligjit për ndërmjetësim, si dhe me raportet e komisioneve të përhershme dhe të komisionit përgjegjës raportues.

Kryetari hodhi në votim, veç e veç, amendamentet e Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi.

Kuvendi miratoi amendamentet: 1,2,3,4,5 dhe 6.

Pastaj, Kryetari e hodhi në votim Projektligjin në tërësi me amendamentet e miratuara. Rezultatet e votimit ishte, si vijon:

Për----- 59;
Kundër----- 0.
Abstenime-----4.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Ligjin për ndërmjetësim.

8. Shqyrtimi i Propozimvendimit për formimin e Komisionit Parlamentar Ad Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se, në bazë të Rregullores nr. 2008/12, për Shërbimin civil, Kuvendi formon Komisionin parlamentar Ad-Hoc për shqyrtimin e kandidaturave për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës.

Komisioni Ad-Hoc përbehet prej nëntë (9) anëtarëve, të cilët propozohen nga partitë ose koalicioni, në bazë të ulëseve të fituara në zgjedhjet për Kuvend, ngjashëm me përfaqësimin e tyre në Kryesinë e Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 9 shtator 2008, ka kërkuar nga kryetarët e grupeve parlamentare që deri në seancën e sotme t'i propozojnë emrat e deputetëve për anëtarë të Komisionit Ad Hoc.

Grupet parlamentare të PDK-së dhe të LDK-së i kanë propozuar anëtarët, kurse ato që nuk i kanë propozuar kërkojnë që t'i propozojnë anëtarët e këtij komisioni.

Kryetarët e grupeve parlamentare i propozuan anëtarët e Komisionit Ad Hoc. Deputetja Kosara Nikoliq tha se Grupi Parlamentar i SLS-së propozimin do ta paraqes me shkrim.

Kryetari hodhi në votim propozimet e grupeve parlamentare. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----57,
Kundër-----0,
Abstenime-----3.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Formohet Komisionit Parlamentar Ad - Hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës, në përbërje:

1. Hydajet Hyseni, Grupi Parlamentar i PDK-së,
2. Ramadan Gashi, Grupi Parlamentar i PDK-së,
3. Ismet Beqiri, Grupi Parlamentar i LDK-së,
4. Melihate Tërmkolli, Grupi Parlamentar i LDK-së,
5. Ibrahim Makolli, Grupi Parlamentar i AKR-së,
6. Adem Salihaj, Grupi Parlamentar i LDD-së,
7. Bajram Kosumi, Grupi Parlamentar i AAK-së,
8. Zylfi Merxha, Grupi Parlamentar "7+",
9. -----, Grupi Parlamentar i SLS-së.

II. Komisioni Parlamentar Ad - Hoc, në bazë të nenit 8.4 të Rregullores nr.2008/12 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.2001/36 mbi Shërbimin Civil të Kosovës, duhet t'i shqyrtojë dhe përzgjedh kandidaturat e paraqitura për anëtarë të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin me rekomandime.

Kryetari e deklaroi të mbyllur seancën në orën 17:15 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:

Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale